



ProCredit Bank

Praktikat më të mira dhe më të sigurta

në kryerjen e transaksioneve
me kartelat tuaja





Mbajtja e kartelës dhe numrit PIN

Përdorimi i kartelës ka vlera dhe mundësi të avancuara në krahasim me paranë e gatshme, ku gjithsesi aspekti i sigurisë është çdo herë në anën e kartelës. Humbja apo vjedhja e kartelës nuk do të thotë domosdoshmërisht humbje e parasë, nëse përdorimi i saj bëhet sipas praktikave me te mira te sigurisë.

Kartela është mjet që ju mundëson pagesa dhe tërheqje të parasë së gatshme, prandaj trajtoni kartelën tuaj me kujdesin e duhur sikurse i trajtoni paratë e gatshme.

Mos lejoni që kartela juaj të fotokopjohet apo fotografohet, të jeni të kujdeshëm pasi që faqja para si dhe faqja e pasme e kartelës përmbajnë të dhëna të ndjeshme siç janë: Numri i kartelës, data e skadencës (para), kodi treshifror –CVV2 (mbrapa), etj të cilat mund të keqpërdoren nëse bien në duar të mashtruesve.

Mbani PIN-in tuaj të fshehtë dhe trajtoni kartelën tuaj me kujdesin e duhur.

Mbajeni në mend PIN-in , mos e ruani PIN-in e kartelës tuaj ose të dhëna të tjera që lidhen me kartelë në kompjuter, telefonin mobil apo edhe letër. Në asnjë mënyre mos lejoni që PIN-i dhe kartela të ruhen së bashku.

Mos e regjistroni ose përdorni PIN-in e kartelës tuaj në mënyrë që do të mundësonite zbulimin e tij nga ndonjë person tjetër.

Mos ia tregoni askujt PIN-in e kartelës tuaj (përfshirë punëtorët e bankës, policinë, etj.)

Përdorimi në ATM (Bankomat)

Keni kujdes gjatë përdorimit të ATM-ve, mos kryeni transaksion nëse ka ndonjë gjë të pazakontë në atë ATM, kushtoni vëmendje të veçantë për çfarëdo pajisje të ngjitur tek lexuesi i kartelave.

Mbuloni PIN tastierën me dorën tjetër derisa e shtypni PIN-in, në këtë mënyrë e ruani PIN-in nga persona apo pajisje vëzhguese të pa autorizuara.

Nëse gjatë përdorimit të kartelës vëreni ndonjë gjë të pazakontë në ATM madje edhe nëse tashmë keni filluar ndonjë transaksion, anuloheni dhe njoftoni Qendrën e thirrjeve të ProCredit Bankë.


Shmangni përdorimin e ATM-it që duket i dyshimtë apo i pazakonshëm në çfarëdo mënyre. Kur të përdorni ATM-in shikoni nëse ka gërvishtje, ngjitës apo mbetjet të shiritit ngjitës të cilat mund të jenë tregues të veprimeve kriminale në ATM.

Mësohuni me pamjën dhe ndjesinë e ATM-it, pamjen e jashtme dhe shenjat standarde.

Mos pranoni ndihmë nga të huajt kur jeni duke operuar me kartelë në ATM.

Nëse kartela juaj është konfiskuar nga ndonjë ATM i ndonjë banke tjetër, ju lutemi të kërkonti bllokim të përkohshëm të kartelës tuaj duke njoftuar qendrën e thirrjeve të bankës. Mos i jepni kurrë kartelën dikujt, trajtojeni si të ishin para të gatshme.





Përdorimi në POS (Terminale të shitjes)

Gjithmonë ruajeni kartelën tuaj, sa herë që e dorëzoni për pagesë, jini të pranishëm derisa kartela juaj është duke u përdorur dhe mos lejoni që ajo të largohet jashtë vështrimit tuaj.

Pasi transaksioni të jetë përfunduar, do të shtypet një faturë.

- Në disa dyqane përveç PIN-it mund të ju kërkohet dhe nënshkrimi i faturës.
 - Sigurohuni që emri juaj, data e transaksionit, numri i kartelës (numrat e fundit), si dhe shuma e faturuar të janë të sakta para se të nënshkruani faturën, duke krahasuar shumë me kuponin fiskal.
-

Ju sugjerohet që gjithnjë të ruani faturën dhe kuponin fiskal përderisa pagesa të pasqyrohet në gjendjen tuaj të llogarisë.

Keni kujdes gjatë përdorimit të POS-ve, mos kryeni transaksion nëse ka ndonjë gjë të pazakontë në atë POS, kushtoni vëmendje të veçantë për çfarëdo pajisje të ngjitur. Njoftoni menjëherë Qendrën e thirrjeve të ProCredit Bank.

Mbuloni PIN tastierën me dorën tjetër derisa e shtypni PIN-in, në këtë mënyrë e ruani PIN-in nga persona apo pajisje të paautorizuara, po ashtu edhe nga vëzhgimet me kamera që pikat e shitjes mund të kenë të vendosura.

Mos pranoni ndihmë nga të huajt kur jeni duke operuar me kartelë në POS.

Përdorimi në Internet

Gjate blerjes përmes internetit, kur ju jeni duke i futur të dhënat e kartelës suaj, sigurohuni që ekrani i kompjuterit tuaj të jetë i fiksuar mirë në mënyrë që të shihet vetëm nga ju.

Përpiquni që të shmangni përdorimin e kompjuterëve publikë për blerje. Preferohet që të lidheni nga shtëpia juaj ose nga kompjuteri juaj personal dhe që të siguroheni se aplikacionet tuaj si 'Firewall' dhe Anti-Virus/Spyware/Malware të jenë të përditësuara ('updated') dhe aktive.

Mos u përgjigj në mesazhet elektronike/thirrjet telefonike që kërkojnë informacione mbi llogarinë tuaj bankare, PIN, iPIN, internet fjalëkalimin (eng. internet password) madje as ProCredit Bank, VISA dhe MasterCard nuk do të kërkojnë kurrë për informata të tilla të fshehta përmes postës elektronike apo përmes telefonit. Nëse pranoi ndonjë kërkesë të tillë ajo mund të jetë mashtrim, në këto raste njoftoni menjëherë Qendrën e thirrjeve të ProCredit Bank.

Mos praktikoni dhënien e numrit të kartelës dhe CVV2 përmes telefonit ose postës elektronike, kjo metodë e autorizimit është shumë e rrezikshme dhe mund të rezultojë në komprometim të kartelës

Aplikoni për iPIN (Internet PIN si dhe fjalëkalimin('password') për internet) për të realizuar pagesa edhe me të sigurt në të gjitha faqet ku gjeni shenjat "MasterCard SecureCode" dhe "Verified by Visa".

Për këtë shërbim ju mund të aplikoni në secilin Bankomat të ProCredit Bank.

Kur të bëni blerje përmes internetit zgjidhni shitësit (faqet) e besueshme dhe verifikoni karakteristikat e sigurisë siç janë: nëse faqja e internetit ka protokoll të sigurisë (<https://>), çertifikata e sigurisë në internet të jetë e vlefshme, etj.

Kur bëni blerje përmes internetit mos klikoni në linçet që ofrohen në reklama ose në postën elektronike me oferta për blerje në internet apo në faqet e tjera të internetit. Në vend të kësaj shtypni vetë adresën në shfletuesin tuaj të ueb faqës.

Kurrë mos e hapni ndonjë dokument të bashkëngjitur të dërguar nga ndonjë person që nuk e njihni. Trajtojeni çdo dokument të bashkëngjitur që e pranoi me kujdes edhe në qoftë se e dini kush e ka dërguar postën elektronike, së pari skanoni për viruse e pastaj hapeni ose ruajeni atë dokument.



Kufizoni publikimin e të dhënave tuaja personale si p.sh. numrin personal, numrin e pasaportës, datën e plotë të lindjes, numrin e kartelës në ndonjë ueb faqe, dritaret e komunikimit ose rrjetet sociale (si p.sh. në Facebook, Twitter) apo ndonjë vend tjetër në mënyrë që të zvogëloni rrezikun e vjedhjes së identitetit tuaj.


Mos i jepni të dhënat e kartelës suaj nëse merrni ndonjë ofertë përmes telefonit/ postës elektronike ose mesazhit në telefon për një produkt / shërbim/ promocion ose mundësi për investime të cilën nuk e keni iniciuar, por edhe nëse e keni iniciuar atë përpara se të vazhdoni me pagesën, ju lutemi të ndërmerrni çdo masë për të qëndruar në anën e sigurt (verifikoni vlefshmërinë e kompanisë, kërkonte dokumentacion të mëtejshëm, konsultohuni me bankën tuaj, etj.).

Çdoherë kur bëni një pagesë ose blerje nëpërmjet internetit, ju lutemi lexoni me kujdes të gjitha afatet dhe kushtet e paraqitura të kompanisë pasi që me konfirmim dhe përfundimin e pagesës i nënshtroheni plotësisht atyre kushteve.

Ju lutemi mos klikoni tastin “PO” në ofertat pa pagesë apo shumë të lira të produkteve/shërbimeve para se t’i lexoni të gjitha afatet dhe kushtet e paraqitura të kompanisë. Në shumicën e rasteve këto oferta kanë të integruara tarifa dhe ngarkesa/ ndalesa të fshehura. Në raste të tilla pa dijeni ju mund të konfirmoni regjistrimin për pagesa/ndalesa periodike të cilat do aplikohen më vonë.

Detaje tjera

CVV2 është numri tre shifror i vendosur vetëm në anën e pasme të kartelës tuaj plastike dhe shërben si numër identifikimi i mbajtësit të kartelës kur bën blerje OnLine ose gjatë porosive telefonike, kështu që, ju lutemi të keni kujdes të mos ia tregoni atë ndonjë pale të tretë.



iPIN do të thotë Internet PIN, dhe shërben për realizimin e blerjeve më të sigurta në internet duke shfrytëzuar kanalin e sigurisë 3-D Secure,

Internet fjalëkalimi (eng. Internet password) shërben për realizimin e blerjeve më të sigurta në internet duke shfrytëzuar kanalin e sigurisë '3-D Secure'.

Për më tepër rreth 3-D Secure vizitoni faqen e ProCredit Bank
(<http://www.procreditbank-kos.com/sq/3-D-Secure>).

Në industrinë e pagesave në internet, butoni "PO" është i njohur si nënshkrim elektronik i klientit, kështu që duke klikuar "PO" ju pajtoheni me afatet dhe kushtet e përcaktuara për ju.

Sigurohuni që kartelat tuaja bankare janë nënshkruar menjëherë në momentin e pranimit dhe që keni nënshkruar me një stilolaps të përhershëm në panelin e nënshkrimit në anën e prapme të kartelës tuaj.

Nënshkrimi juaj në fletat e pagesave përmes POS duhet të jetë identik me atë në kartelën tuaj. Nënshkrimi ju identifikon juve si mbajtësi i kartelës prandaj duhet të jetë i njëjtë.

Na njoftoni menjëherë në Qendrën e Thirrjeve nëse mendoni se dikush mund të dijë ndonjë nga të dhënat tuaja të fshehta të kartelës, nëse e keni humbur atë ose nëse kartela juaj është vjedhur.

Nëse kartela juaj ka skaduar, ju lutemi shkatërrojeni atë plotësisht.

Sigurohuni që ProCredit Bank gjithmonë të posedojë numrin e saktë të telefonit apo celularit si dhe një postë elektronike personale (e-mail), kështu që në qoftë se është regjistruar ndonjë lëvizje e dyshimtë në llogarinë tuaj, ne mund t'ju kontaktojmë. Megjithatë, edhe në ato raste, ne kurrë nuk do t'ju kërkojmë të zbuloni të dhënat tuaja të fshehta si: PIN-i i kartelës, CVV2, iPIN-in dhe fjalëkalimin për internet.

Që ta kontrolloni në mënyrë efikase aktivitetin e llogarisë suaj fuqimisht ju këshillojmë:

- Të kontrolloni rregullisht llogaritë tuaja.
 - Të aktivizoni njoftimin me SMS për transaksionet tuaja.
-

Në rast se vëreni ndonjë lëvizje të paautorizuar në llogari, apo keni pranuar me SMS ndonjë njoftim për transaksion të paautorizuar nga ju, ju lutem të kontaktoni menjëherë Qendrën e Thirrjeve të ProCredit Bank.
